



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:017274
Datë: 23.12.2024
Numri i dokumentit: 06642906

C-IV-24-0192

Ankuesi

F F Fshati B, Podujevë
Përfaqësuar nga Av:B I, Prishtinë

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 23 dhjetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. **PRN046-0116**, datë 21 korrik 2014.
- OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **F F** në emër të kompensimit për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës, t'i paguaj **shumën prej 953.01 Euro**, dhe në emër të interesit ligjor 10 % **shumën prej 95.30 Euro**, të cilat do të paguhen në procedurën e likuidimit sipas prioriteteve të kërkesave dhe interesave, sipas nenit 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së (Ligji nr. 04/L-034).
- Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 14 gusht 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN-046-0115, të datës 21 korrik 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për pagat e pa paguara, për periudhën nga dhjetori 2002 deri në mars 2005, në shumë prej 1,656.66 Euro dhe vendimit me nr. **PRN046-0116**, të datës 21 korrik 2014, me të cilin ka kërkuar

kompensim, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë dhe periudhë të paspecifikuar, nga NSH FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim).

Ankuesi pohoi se është njoftuar nga AKM që vepronte në atë kohë, se shitja e NSH është vërtetuar nga bordi i AKM dhe se i është përfunduar kontrata e punësimit si dhe është njoftuar se shumat-pagat që NSH ka mbetur borxh është përgjegjësi e punëdhënësit, ndërsa kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit. Po ashtu ankuesi pohoi se njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies se punës është në kundërshtim me vendimin për refuzimin e kërkesës, sepse nuk është vonuar në kohë për të aplikuar për kompensimin e pagave, pasi që në njoftim ka mbetur që AKM do të na kontaktojë kur të jetë koha për të parashtruar kërkesën. Në mbështetje të kërkesës ankuesi ka bashkangjitur dokumentet në kopje si: vendimet e lartë cekura të kundërshtuara të AL-së, si dhe certifikatën mbi kohën e papunësisë.

Me 31 janar 2020, e paditura AKP-ja parashtroi mbrojtje në ankesë, në të cilën ka pohuar se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Po ashtu, e paditura pohoi se pretendimet e ankuesit janë të parashkruara, pasi që i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik kundër NSH-së gjatë periudhës mars 2005 – mars 2008. Sipas të paditurës afati i parashkrimit nuk e lejon AL-në dhe Dhomën e Posaçme të analizojë dhe shqyrtojë themelin e rastit.

Me 02 qershor 2021, gjykata, për ankuesin lëshoi vërejtje për pagesën e taksave gjyqësore. Ankuesi me 18 qershor 2021, e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 20 Euro.

Me Aktgjykimin C-IV-14-5848 të datës 29 mars 2024, Dhoma e Posaçme e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Me Aktvendimin AC-I-24-0309, të datës 05 dhjetor 2024, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme, e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë, ndërsa lënda është kthyer në rigjykim, për të vendosur për vendimin e AL-së, me Nr. PRN046-0116, për ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës.

Me 21 korrik 2023, gjykata në procedurë të rigjyimit lëshoi urdhër për ankuesin, me të cilin është kërkuar nga ankuesi që të dërgoi prova shtesë, në mbështetje të ankesës së parashtruar.

Me 31 korrik 2023, përfaqësuesi i ankuesit është përgjigjur në urdhër, duke dorëzuar provat:

- vërtetimin për përvojën e punës,
- librezën e punës,
- lista përfundimtare e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave,
- Lista e pagave për muajt janar, shkurt, mars 2006,
- letra për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e datës 24 mars 2006
- kopjen e vendimit PRN046-0116, të datës 21 korrik 2014, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë dhe kohë të pacaktuar.
-

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL-së PRN046-0116, i datës 21 korrik 2014.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Fan Zahir Pajaziti” në Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në librezën e punës, listën e pagesave vjetore për vitin 2004 dhe 2005, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë.

Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune në NSH “Fan Zahir Pajaziti” nga data 03 maj 1984 deri më 17 shtator 1992 dhe nga data 01 shtator 1999 deri më 24 mars 2006, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara librezën e punës dhe listë pagesën

vjetore, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listë pagesën vjetore të pagave lëshuar nga personi përgjegjës i NSH-së.

Gjykata ka vlerësuar se sa i përket vendimit PRN046-0116, të datës 21 korrik 2021, me të cilin ankuesi ka kërkuar kompensim për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës, në bazë të librezës së punës vërtetohet se ankuesi kishte punuar 14 vjet e 11 muaj e 7 ditë dhe dëshmime të lartë cekura, që tregojnë se ankuesi ishte punëtor në NSH, vërtetohet se ankuesit në bazë të pagës së fundit të paguar, i takojnë 953.01 Euro tri paga (317.07x 3).

Neni 12.2 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: “Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme:

(dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t'i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

- (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;*
- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;*
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;*
- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;*
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore;*

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 953.01 Euro, për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në provat, si: letrën për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të datës 24 mars 2006, vërtetimin e përvojës së punës me numër 131/2, i datës 11 shkurt 2013, listë pagesën e pagave, librezën e punës, me numër. 219685, si dhe vendimin e AL-së, të cekur më lartë

Gjykata vëren se letra e datës 24 mars 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësaj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesi, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesi me letrën e datës 24 mars 2006 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kësaj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kësaj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe

përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit. Njëherit një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (AC-I-20-0282, AC-I-20-0033, AC-I-20-0168 , AC-I-20-0183 etj).

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi **F F** kishte ofruar shërbime punë për NSH-në dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh pagat për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe kësaj i takon e drejta në kompensim, në shumën e aprovuar më lartë.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 95.30 Euro, në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Sa i përket vendimit PRN046-0115, i datës 21 korrik 2014, për paga të papaguara, është vendosur me aktgjykimin më parë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës.

E paditura është obliguar ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 104.00 €, në bazë të rregullores së tarifës së Odës së Avokatëve,

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrihet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare